



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-11262-1033
Datë: 08.01.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Ligjit numër 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me qëllim të autorizimit të Zyrtarit Kryesor Financiar në Komunën e Gjakovës, me datë 08.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja **Gentiana Qurdina Nixha**, e sistemuar në punë Udhëheqëse e Sektorit për Buxhet, **caktohet Zyrtar Kryesor Financiar** në Komunën e Gjakovës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar janë të përcaktuara me legjislacionin përkatës për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Gjakovës, Rregulloren numër 01-011/01-16155 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, me legjislacionin tjetër në fuqi si dhe kryen detyra tjera shtesë të caktuara nga Kryetari i Komunës.
3. Kompensimi i pagës bëhet sipas koeficientit 7.26 (klasa GJ3 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
4. Zyrtari Kryesor Financiar është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në përputhje me Ligjin numër 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
5. Autorizimi i Zyrtarit Kryesor Financiar mbetet në fuqi deri në shfuqizimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit e të njëjtit. Ankesa i adresohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Vendimi iu dorëzohet:

- Të autorizuarës Gentiana Qurdina Nixha
- Njësive organizative në komunë
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit